

Z.Agron Cani

punon në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar /DSIK/ që nga viti 2003. Fillimisht, për periudhën 1983 – 2003, ka punuar si Oficer pranë Ministrisë së Rendit. Më pas, deri në vitin 2005 ka qenë Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Dokumentave. Nga viti 2008 e në vazhdim ushtron detyrën e Drejtorit të Sigurimit, Administrimit të Dokumentave dhe Regjistrimit Qendror.

Në pozicionin aktual, drejton dhe menaxhon punën e Sektorit të Regjistrimit Qendror të NATO-s dhe të Sektorit të Sigurimit dhe Administrimit të Dokumentave. Harton politika, programe e procedura për sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” dhe të NATO-s dhe kontrollon zbatimin e tyre. Mbikqyr ministritë dhe institucionet e tjera shtetërore lidhur me krijimin, regjistrimin, qarkullimin, shumëfishimin, shfrytëzimin, transportimin fizik, asgjësimin, shkatërrimin, arkivimin, deklasifikimin, zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.

Gjatë punës së tij, ai bashkëpunon me stafin që drejton, ministritë dhe institucione të tjera ligjzbatuese.

Ka përfunduar studimet e larta në Akademinë e Sigurisë (ish-shkolla e lartë e MPB) dhe në Fakultetin e Drejtësisë. Është trajnuar për çështjet e sigurisë, inteligjencës dhe të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar.